



Technical Secretariat of the
National Water Council

FUNKSIONIMI I KBU

**ORGANIZIMI I MBLEDHJES, ZHVILLIMI,
VENDIMMARRJA, HYRJA NË FUQI E VENDIMEVE**

VLORE 28 QERSHOR 2018

QËLLIMI I PREZANTIMIT

Organizimi dhe zhvillimi i mbledhjeve efektive për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të ngarkuara nga aktet ligjore e nënligjore për menaxhimin dhe administrimin e integruar të burimeve ujore.

VEPRIMET PROCEDURALE

Organizimi i mbledhjes

Zhvillimi i mbledhjes

❖ **ORGANIZIMI I MBLEDHJES.**

❖ **ZHVILLIMI.**

❖ **FORMALIZIMI I VENDIMEVE.**

❖ **HYRJA NË FUQI E VENDIMEVE.**

❖ ORGANIZIMI I MBLEDHJES

- a. Përgatitja e rendit të ditës nga drejtuesi i Agjencisë;
- b. Miratimi i rendit të ditës;
- b. Thirrja e mbledhjes;
- c) Përgatitja e mbledhjes;

a. Përgatitja e rendit të ditës

Drejtuesi i Agjencisë përgatit rendin e ditës dhe ja propozon për miratim Kryetarit.

- Rendi i ditës përmban:

i) Datën dhe orën për zhvillimin e mbledhjes;

ii) Tematikën që do të trajtohet;

iii) Propozimet dhe kërkesat që do të shqyrtohen;

iv) Problemet e ndryshme që do të diskutohen.

b. Miratimi i rendit të ditës

Miratimi i rendit të ditës nga Kryetari.

Të drejtat e Kryetarit:

- i) E drejta për të vendosur për datën dhe orën e mbledhjes;
- ii) E drejta për të ndryshuar rendin e ditës të propozuar nga drejtuesi i Agjencisë;
- iii) E drejta për të përfshirë në rendin e ditës çështje që nuk janë propozuar nga drejtuesi i Agjencisë.

c. Thirrja e mbledhjes

- Mbledhjet thirren nga Kryetari jo më pak se një herë në dy muaj;
- Mbledhjet thirren dhe me kërkesën me shkrim të 1/3 e anëtarëve.

Procedura e thirrjes së mbledhjes ndiqet nga ABU nëpërmjet këtyre veprimeve:

- Njoftimi i anëtarëve të KBU, Sekretariati Teknik të KKU (AMBU) për datën dhe orën e mbledhjes dhe për rendin e ditës;*
- Anëtarëve u vihet në dispozicion materiali që do të shqyrtohet në mbledhje; (në format letër ose në format elektronik)*
- Anëtarët dhe STKKU (AMBU) vihen në dijeni për mbledhjen jo më vonë se 7 ditë përpara datës së caktuar;*

Kur mbledhja kërkohet nga 1/3 e anëtarëve:

- Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen;
- Agjencia njofton anëtarët dhe STKKU (AMBU) brenda 15 ditëve pas datës së paraqitjes së kërkesës.

d. përgatitja e mbledhjes

Agjencia organizon punën për përgatitjen e mbledhjes

Nëpërmjet këtyre veprimeve, si:

- i) Sigurimi i ambientit ku do të zhvillohet mbledhja;*
- ii) Përgatit materialet që u vihen në dispozicion anëtarëve sipas rendit të ditës;*
- iii) Merr masa për regjistrimin e mbledhjes në procesverbal etj.*

❖ ZHVILLIMI I MBLEDHJES

- a. Pjesmarrja;
- b. Kryesimi dhe drejtimi;
- c. Mënyra e zhvillimit;
- ç) Prezantimi i propozimeve, diskutimi dhe kalimi për votim;
- d) Konflikti i interesit;
- dh) Marrja e vendimit.

a. pjesmarrja

- Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit, (përveç rasteve kur në ligj kërkohet një shumicë e cilësuar) një prej të cilëve duhet të jete kryetari ose nënkryetari.
- Drejtuesi i Agjencisë merr pjesë rregullisht në mbledhje pa të drejtë vote.

b. kryesimi dhe drejtimi i mbledhjes

- i) Mbledhja kryesohet dhe drejtohet nga Kryetari;
- ii) Në mungesë të kryetarit, mbledhja drejtohet nga nënkryetari;

Drejtuesi i mbledhjes drejton diskutimet, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve te drejta.

c. mënyra e zhvillimit të mbledhjes

- i) Mbledhja bëhet me dyer të mbyllura. Ne të mund të marrin pjesë përfaqësues të STKKU (AMBU).
- ii) Me propozim të Kryetarit, mbledhjet bëhen me dyer të hapura. Në këtë rast Agjencia merr masa për njoftimin e palëve të interesuara. Ky njoftim behet te paktën 2 dite para datës së mbledhjes.
- iii) Me propozim të Kryetarit, për çështjet që nuk janë parashikuar në rendin e ditës, këshilli mund të vendosë zhvillimin e mbledhjeve jashtë radhe për shqyrtimin e tyre.

ç. prezantimi i projektakteve, diskutimi dhe kalimi për votim

- i) Prezantimi i projektaktit bëhet nga propozuesi;
- ii) Kërkesat për leje/autorizime prezantohen nga drejtuesi i Agjencisë (ZABU);
- iii) Pas prezantimit ftohen anëtarët për diskutim;
- iv) Propozuesi ka të drejtë të tërheqë projektaktin deri para votimit;
- v) Pas diskutimeve, drejtuesi fton anëtarët për votim.

d. konflikti i interesit

Zbatohen dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore për konfliktin e interesit;

Anëtari në kushtet e konfliktit të interesit:

- i) *Duhet ta deklarojë paraprakisht;*
- ii) *Nuk duhet të marre pjesë ne diskutimin dhe votimin e çështjes;*
- iii) *Në rast së një anëtar ndodhet në kushte të përhershme të konfliktit të interesit, Kryetari duhet t'i kërkojë institucionit, që ai përfaqëson, zëvendësimin e tij.*

Pasoja:

- **Vendimet e marra në kushtet e konfliktit të interesit janë absolutisht të pavlefshme.**
- **Anëtari në kushtet e konfliktit të interesit gjobitet nga ILDKPI në masën e parashikuar në ligj.**
(100.000-300.000 lekë)

d. marrja e vendimit

- i) KBU merr vendime vetëm për çështjet e përfshira në rendin e ditës;
- ii) Votimi është i hapur
- iii) Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve pjesmarrës, përveç kur në ligj kërkohet shumicë e cilësuar;
- iv) Anëtarët e pranishëm nuk mund të abstenojnë;
- v) Drejtuesi i mbledhjes voton i fundit;
- vi) Kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare;
- vii) Kur rezultati i votimit është i barabartë dhe mbledhja drejtohet nga nënkryetari, vendimi shtyhet në mbledhjen pasardhëse të kryesuar nga Kryetari.

❖ FORMALIZIMI I VENDIMEVE

- i) Vendimi i KBU formalizohet nga drejtuesi i Agjencisë dhe nënshkruhet nga drejtuesi i mbledhjes (*Kryetari ose Nënkyetari*);
- ii) Vendimi formalizohet brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes;
- iii) Formulari i lejes/autorizimit plotësohet brenda 5 ditëve nga data e nënshkrimit të vendimit;
- iv) Vendimet formalizohen në 3 kopje; (*për arkivën e Prefektit, Agjencisë dhe STKKU*).

❖ HYRJA NË FUQI E VENDIMEVE

- i) Vendimet me karakter normativ hyjnë në fuqi pas publikimit me mjetet e informimit publik;
- ii) Vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi pas zbardhjes së tyre dhe njoftimit të subjektit të interesuar;
- iii) Lejet dhe autorizimet hyjnë në fuqi pasi njoftohet subjekti dhe publikohen në regjistrin e licencave dhe lejeve.



Technical Secretariat of the
National Water Council

FALEMINDERIT !